



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Lluka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Rexhep Selimit (“z. Selimi” ose “i akuzuari”) është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme në lidhje me paraburgimin. Zhvillimet përkatëse që nga rishikimi i trembëdhjetë i paraburgimit të z. Selimi më 15 janar 2024 (“Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin”) përfshijnë si vijon.¹

2. Më 23 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi parashtrimet në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të z. Selimi (“Parashtrimet e ZPS-së”).²

3. Mbrojtja e z. Selimi (“Mbrojtja e Selimit”) nuk iu përgjigj Parashtrimeve të ZPS-së.

II. PARASHTRIMET

4. ZPS-ja kërkon vazhdimin e paraburgimit të z. Selimi pasi, që nga rishikimi i fundit i paraburgimit të z. Selimi, nuk ka pasur asnjë ndryshim material të rrethanave që do të ndikonte në faktorët që mbështesin domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e paraburgimit.³ Përkundrazi, ZPS-ja parashtron se zhvillimet e

¹ F02060, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 15 janar 2024.

² F02146, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 23 shkurt 2024.

³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

konsiderueshme të kohëve të fundit, së bashku me vazhdimin e gjykimit, si dhe zhvillime të tjera të konsiderueshme që i mundësojnë z. Selimi të vazhdojë të ketë qasje në informacion lidhur me dëshmitarë të cënueshëm dhe provat kundër tij, rrisin domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e paraburgimit të tij.⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Dispozitat ligjore të zbatueshme për vendimin në lidhje me paraburgimin përcaktohen në nenin 41(6), (10) dhe (12), dhe rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme.⁵ Në këtë vendim Trupi Gjykes do të zbatojë po këto standarde.

IV. DISKUTIM

6. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që të përcaktohet nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtjen në paraburgim.⁶ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse shtrohet para trupit gjykues përkatës, ose *proprio motu*.⁷

⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁵ *Shih, për shembull*, F00580, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me Rishqyrtimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Mbajtjes në Paraburgim të Rexhep Selimit*, ("Vendimi i Tretë për Paraburgimin"), 26 nëntor 2021, konfidencial, para. 20, me referenca të mëtejshme. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 dhjetor 2021, F00580/RED.

⁶ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA022/F00005/RED.

⁷ IA007/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 14. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA007/F00005/RED.

A. KRITERET E NENIT 41

1. Dyshimi i bazuar

7. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.⁸

8. ZPS-ja parashtroi se vijon të përmbushet kriteri i neni 41(6)(a). Sipas saj, nuk ka pasur asnjë ndryshim që do të mund të cenonte konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar mirë se z. Selimi ka kryer vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.⁹

9. Trupi Gjykues vë në dukje se, në bazë të neni 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Selimi është përgjegjës penalisht për disa krime kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁰ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se dyshimi i bazuar mirë është vërtetuar edhe në lidhje me akuzat e reja të

⁸ Ngjashëm, ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹⁰ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED, Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar në parashtrimin F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial të korrigjuar me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

ngritura nga ZPS-ja kundër z. Selimi , të paraqitura në ndryshimet e kërkuara që i janë bërë Aktakuzës.¹¹ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).¹²

10. Në mungesë të ndonjë rrethane materiale të re që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Selimi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

2. Domosdoshmëria e paraburgimit

11. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative, në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së krimeve të tjera.¹³ Këto arsye duhet të jenë të “artikulueshme” në kuptimin që duhet të specifikohen me hollësi duke iu referuar

¹¹ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00777/RED) dhe versioni konfidencial me më pak redakte (F00777/CONF/RED2), u dorëzuan përkatësisht më 22 prill 2022, 6 maj 2022 dhe 16 maj 2022. Ndryshimet e kërkuara janë përshkruar me hollësi në para. 11. Aktakuza e ndryshuar e konfirmuar u dorëzua nga ZPS-ja më pas më 29 prill 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar më tej (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00999/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03), siç kishte urdhëruar Gjykatësi i Procedurës Paraprake (F00895, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 22 korrik 2022, para. 49(e); F00993, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 24(b); versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00993/RED).

¹² *Shih për shembull*, F00372, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Rexhep Selimit* (“Vendimi i Dytë për Paraburgimin”), 25 qershor 2021, konfidencial, para. 19. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2021, F00372/RED.

¹³ *Shih* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, 9 February 2021, [Judgment](#), para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, 17 September 2020, [Judgment](#), para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, 4 July 2019, [Judgment](#), para. 155.

informacionit ose provave përkatëse.¹⁴ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjë prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.¹⁵

(a) Rreziku i arratisjes

12. ZPS-ja parashtrohet se z. Selimi vazhdon të përmbushë standardin e zbatueshëm të rrezikut të arratisjes. Konkretisht, ZPS-ja pretendon se z. Selimi: (i) është vënë në dijeni të akuzave kundër tij dhe mundësisë së një dënimi të rëndë, në rast se shpallet fajtor; dhe (ii) përmes procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialit, ai është duke marrë më shumë njohuri për provat kundër tij. ZPS-ja shton se këto përfundime bëhen edhe më domethënëse për shkak të vazhdimit të gjyqimit ku z. Selimi sheh se si provat fajësuese kundër tij po bëhen pjesë e dokumentacionit të çështjes.¹⁶ ZPS-ja gjithashtu pretendon se z. Selimi tani është i vetëdijshëm për provat se ai është orvatur të pengojë procesin dhe të kryejë krime të tjera, që çoi në modifikimin e kushteve të paraburgimit të tij. ZPS-ja argumenton se, si rezultat, edhe pse më parë Trupi Gjyqësor njohu bashkëpunimin e z. Selimi me autoritetet përkatëse për paraburgimin e tij, kjo nuk qëndron më.¹⁷ Së fundi, ZPS-ja argumenton se të gjithë faktorët e mësipërm duhet të merren parasysh në kontekstin e konstatimeve të mëhershme në lidhje me mjetet për udhëtim të z.

¹⁴ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të Vitit 2022, Ligji nr. 08/L-032, jep këtë përcaktim për termin “artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”. *Shih gjithashtu* IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit mbi Lirimin e Përkohshëm (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit”)*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 43. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA003/F00005/RED.

¹⁵ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 40.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9 që i referohen Vendimit të Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 13.

Selimi dhe mundësisë që aktualisht kanë qytetarët e Kosovës për të udhëtuar pa viza në Bashkimin Evropian ("BE").¹⁸

13. Trupi Gjykses ka shqyrtuar argumentet e ZPS-së duke marrë parasysh fazën aktuale të procesit dhe nuk gjykon se vazhdimi i gjykimit përbën faktor relevant të ri. Në lidhje me argumentin e ZPS-së se rreziku i arratisjes është më i lartë duke pasur parasysh se z. Selimi tani është i vetëdijshëm se ZPS-ja ka mbledhur prova kundër tij për pengim të procesit, Trupi Gjykses thekson se z. Selimi tashmë përballet me akuza që lidhen me krime ndërkombëtare themelore, dhe provat e reja për pengim nuk përbëjnë ndryshim të madh të rrethanave që përlligj një konstatim të ndryshëm mbi rrezikun e arratisjes.

14. Së fundi, argumenti i ri i ZPS-së për mundësinë e udhëtimit pa viza të qytetarëve të Kosovës në BE, nuk ndikon në konstatimet e mëparshme të Trupit Gjykses se në lidhje me z. Selimi nuk është vërtetuar rreziku i arratisjes. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rikonfirmon konstatimin e vet të mëparshëm se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin e "mundësisë mjaftueshëm reale" që i akuzuari do të arratiset nëse lirohet.¹⁹

15. Trupi Gjykses konstaton se, megjithëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet tërësisht asnjëherë, vazhdimi i paraburgimit të z. Selimi aktualisht nuk mund të përlligjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

16. ZPS-ja parashtron se z. Selimi vazhdon të paraqesë rrezik për pengimin e procesit. Ajo parashtron se vazhdojnë të ekzistojnë faktorët e rrezikut që evidentoi Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe konfirmoi Trupi Gjykses, , konkretisht:

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

¹⁹ *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 13-14; *Shih gjithashtu* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 44.

(i) postet e kaluara dhe aktuale me ndikim në Kosovë të z. Selimi, përfshirë si ministër i Punëve të Brendshme dhe si i zgjedhur në Kuvendin e Kosovës, do t'i mundësonin që të ushtronte ndikim në rrjetin e mbështetësve të tij dhe ta mobilizonte atë; (ii) atmosfera e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"); dhe (iii) ecuria e procesit përmes të cilit z. Selimi vazhdon të njihet me provat në të cilat bazohen akuzat e rënda kundër tij.²⁰

17. ZPS-ja shton se në Kosovë vazhdon atmosfera e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në lidhje me këtë çështje, për të cilën Paneli i Gjykatës së Apelit është pajtuar se është faktor relevant.²¹

18. Së fundi, ZPS-ja parashtron se z. Selimi ka marrë informacion të ndjeshëm, ndër të tjera, në lidhje me dëshmitarët që ZPS-ja synon t'i thërrasë.²² ZPS-ja shton se ajo ka theksuar më parë rrezikun që ky informacion të bëhet i njohur për publikun, përmes të akuzuarit, dhe se ky rrezik tashmë është materializuar, pasi z. Selimi ka shkelur urdhrat e Trupit Gjykses, ndër të tjera, duke zbuluar identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur dhe/ose duke ua shpërndarë përmbajtjen e dëshmive konfidenciale personave që e kanë vizituar në objektin e paraburgimit të DHS-së, çka rezultoi në modifikimin prej Trupit Gjykses të kushteve të paraburgimit të z. Selimi.²³

19. Trupi Gjykses tërheq vëmendjen në lidhje me standardin e përdorur në vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), që nuk kërkon "shembull konkret" të një situatë ku z. Selimi të ketë frikësuar ose ngacmuar personalisht një dëshmitar.

²⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10-11.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-14.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14-16 që i referohen F01977, Trupi Gjykses, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, dhe Rexhep Selimin* ("Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit"), 1 dhjetor 2023, para. 41, 51-53, 55-60, 62-78, 84(c).

20. Trupi Gjykues ka konstatuar tashmë dhe rithekson se: (i) postet me ndikim, të kaluara dhe aktuale, të z. Selimi në Kosovë, përfshirë si ministër i Punëve të Brendshme dhe si i zgjedhur në Kuvendin e Kosovës, do t'i mundësonin që të ushtronte ndikim në rrjetin e mbështetësve të tij dhe ta mobilizonte atë;²⁴(ii) ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së;²⁵ dhe (iii) procesi vazhdon dhe z. Selimi vijon të njihet me provat në të cilat bazohen akuzat e rënda kundër tij.²⁶

21. Siç është vënë në dukje më parë, për shkak të natyrës së gjykimit që po zhvillohet, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për Mbrojtjen e Selimit, dhe, rrjedhimisht, do të bëhen të njohur për një numër të madh personash, përfshirë të akuzuarin. Kjo nga ana e vet, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi. Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari që zotëron informacion të

²⁴ *Shih, për shembull*, F00179, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Lirim të Përkohshëm* ("Vendimi i Parë për Paraburgimin"), 22 janar 2021, konfidencial, para. 37. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 janar 2021, F00179/RED; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 40; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 33; F00802, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit* ("Vendimi i Katërt për Paraburgimin"), 13 maj 2022, konfidencial, para. 31. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 maj 2022, F00802/RED; F01213, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit* ("Vendimi i Shtatë për Paraburgimin"), 17 janar 2023, konfidencial, para. 23-24. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 janar 2023, F01213/RED; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 19.

²⁵ *Shih, për shembull*, Vendimin e Parë për Paraburgimin, para. 42; Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 41; Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 34; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 23-24; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 19.

²⁶ *Shih, për shembull*, Vendimin e Katërt për Paraburgimin, para. 33; F00979, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 19 shtator 2022, konfidencial, para. 29. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 shtator 2022, F00979/CONF/RED; F01111, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 18 nëntor 2022, konfidencial, para. 27. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F01111/RED; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 23-24; Vendimi i Trembëdhjetë, para. 19.

ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efektive të dëshmitarëve që ende nuk kanë dëshmuar.²⁷

22. Në lidhje me sjelljen e z. Selimi në objektin e paraburgimit të DHS-së, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet të se duket se z. Selimi nxori informacion konfidencial për palë të treta të paautorizuara.²⁸ Kjo sjellje mbështet dhe përforcon konstatimin e Trupit Gjykses se lirimi i z. Selimi përbën rrezik të pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së.

23. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses arrin në përfundim se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Selimi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, siç përcaktohet në nenin 41(6)(b)(ii).

(c) Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

24. ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Selimi të kryejë krime të tjera. Konkretisht, ZPS-ja parashtron se faktorët që u vlerësuan në lidhje me ekzistencën e rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii), janë relevantë edhe për shqyrtimin nëse ekziston rreziku i kryerjes së krimeve të tjera në rast të lirimit të z. Selimi.²⁹ ZPS-ja parashtron se ky rrezik është bërë edhe më i rëndësishëm për shkak të informacionit të ndjeshëm që z. Selimi vazhdon të marrë që nga fillimi i gjykimit³⁰ dhe duke pasur parasysh konstatimin e bërë së fundmi se z. Selimi ka nxjerrë informacion konfidencial.³¹ ZPS-ja shton se krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës për të cilat akuzohet z. Selimi janë tejet të rënda dhe

²⁷ *Shih, për shembull*, Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 24; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 20.

²⁸ Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, para. 35-37.

²⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17-18.

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 20-21.

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21.

pretendohet se janë kryer në bashkëpunim me të tjerë si dhe personalisht nga z. Selimi.³²

25. Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Selimi të kryejë krime të tjera.³³ Trupi Gjykues konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit, janë relevantë edhe për analizimin e rrezikut që z. Selimi të kryejë krime të tjera.³⁴ Trupi Gjykues vë në dukje gjithashtu se rrethanat e reja që janë krijuar që nga rishikimi i fundit i paraburgimit, nuk përlligjin një konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

26. Trupi Gjykues thekson faktin se gjykimi i kësaj çështjeje ka filluar dhe se duhet të shmanget çdo rrezik i kryerjes së krimeve të tjera.

27. Trupi Gjykues gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Selimi të kryejë krime të tjera sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

3. Përfundim

28. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se në këtë fazë vazhdon të mos ketë informacion të mjaftueshëm që të përlligjë konstatimin se z. Selimi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë, në bazë të standardit përkatës, Trupi Gjykues është bindur se ekziston rreziku që z. Selimi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose kanë për t'u paraqitur para DHS-së. Në vijim, Trupi Gjykues do të

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

³³ Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 24.

³⁴ *Shih më lart*, para. 20-22; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 24.

vlerësojë nëse kushtet për lirimin e z. Selimi trajtojnë në mënyrë të mjaftueshme këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

29. ZPS-ja parashtron se asnjë masë alternative nuk zvogëlon mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b) që paraqet z. Selimi. ZPS-ja kujton se Trupi Gjykses ka konstatuar më parë se rreziqet e pengimit të procesit dhe kryerjes së veprave të tjera penale mund të kontrollohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.³⁵ ZPS-ja shton se që nga Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm. Përkundrazi, sjellja e z. Selimi përbën rrezik më të lartë se kurrë, sikurse dëshmohej nga modifikimi prej Trupit Gjykses i kushteve të paraburgimit me vendosjen e kushteve më të rrepta.³⁶

30. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).³⁷ Neni 41(12) përcakton disa faktorë që duhet të merren parasysh për të siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, apo për të siguruar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme masa alternative më të buta, të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara

³⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22-25.

³⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

³⁷ Sa i përket detyrimit për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

në nenin 41(6)(b).³⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat e arsyeshme alternative që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtrojnë palët.³⁹

31. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së krimeve të tjera, Trupi Gjykses konstaton se asnjë nga kushtet e propozuara më parë e as ndonjë nga masat e përcaktuara në nenin 41(12) të urdhëruara *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁴⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të para në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me synim zvogëlimin e rrezikut të pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁴¹ Për më tepër, ato ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të evidentohet dhe/ose të parandalohet më me lehtësi.⁴²

32. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se vetëm përmes kornizës për kufizimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së, dhe masave të urdhëruara së fundmi prej Trupit Gjykses, ⁴³ mund të kufizohen

³⁸ Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 prillit 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

³⁹ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 86.

⁴⁰ Shih, *për shembull*, Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 72; IA015/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit* ("Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit"), 25 mars 2022, konfidencial, para. 33-44, 48-52, 61. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA015/F00005/RED; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 59; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 39; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30.

⁴¹ Shih *për shembull*, Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 72; Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 33-44, 48-52, 61; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 59; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30.

⁴² Shih, *për shembull*, Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 61; Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 42; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 59; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 38; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30.

⁴³ Shih Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, para. 51-53, 55-60, 62-78, 84(c).

komunikimet e z. Selimi, në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁴⁴ Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka masa të tjera alternative përveç vazhdimit të paraburgimit të z. Selimi që mund të shmangin në masë të mjaftueshme rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

33. ZPS-ja parashtron se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët, paraburgimi i z. Selimi vazhdon të jetë i arsyeshëm.⁴⁵ Në lidhje me këtë, ZPS-ja i referohet konstatimit të Trupit Gjykses se: (i) kundër z. Selimi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare, dhe pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm në përgatitjen e tyre; (ii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) procesi është kompleks; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b) nuk mund të zvogëlohen në mënyrë të mjaftueshme me masa më të buta se paraburgimi; (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve; dhe (vi) gjykimi ka filluar.⁴⁶

34. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria e vazhdimit të paraburgimit të një të akuzuari duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas veçorive të saj në kohën kur bëhet vlerësimi.⁴⁷ Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, në veçoritë e kësaj çështjeje përfshihen: (i) kundër z. Selimi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare, në të cilat pretendohet se ka luajtur rol të rëndësishëm;⁴⁸ (ii) nëse shpallet fajtor, z. Selimi mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara

⁴⁴ *Shih, për shembull*, Vendimin e Tretë për Paraburgimin, para. 61; Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 42; Vendimi i Katërt për Paraburgimin, para. 59; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 38; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 31.

⁴⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27, 29.

⁴⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 28.

⁴⁷ Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 42 (me referenca të mëtejshme).

⁴⁸ Aktakuza e Konfirmuar, para. 7-9, 32, 39-40, 44-47, 49, 52, 55-57, 176-177.

dhe/ose me asnjë kusht tjetër;⁴⁹ (iv) çështja kundër z. Selimi është komplekse;⁵⁰ (v) atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve e përshkruar më lart; dhe (vi) fakti që gjykimi ka filluar.

35. Duke marrë parasysh zhvillimet e mësipërme, si dhe faktin se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së krimeve të tjera, ku asnjë prej këtyre rreziqeve nuk mund të zvogëlohet mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative, Trupi Gjykses konstaton se, në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, vazhdimi i paraburgimit të z. Selimi me dy muaj të tjerë, është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

36. Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se z. Selimi tashmë mbahet në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje ka mundësi të zgjasë. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykses, kjo kërkon që Trupi Gjykses, si edhe palët, të kenë veçanërisht parasysh që të sigurojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykses do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

⁴⁹ *Shih më lart*, para. 32.

⁵⁰ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 79 (me referenca të mëtejshme); Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 33.

V. VENDIM

37. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Selimi; dhe
- b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Selimi jo më vonë se **të mërkurën, 24 prill 2024 (në orën 16:00)**, me përgjigjen dhe kundërpërgjigjen sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 15 mars 2024

Në Hagë, Holandë.